

I jepet lamtumira e fundit Kryepiskopit Anastas Janullatos



Ka përfunduar ceremonia mortore për Kryepiskopin Anastas Janullatos.

Qindra besimtarë, klerikë dhe hierarkë të lartë nga e gjithë bota ishin të pranishëm në ceremoni për t'i dhënë lamtumirën e fundit Fortlumturisë së Tij Anastas.

Patriarku Ekumenik i Konstandinopojës Bartolomeu drejtoi ceremoninë mortore të Kryepiskopit duke përcjellë mesazhin se Kryepiskopi Anastas ishte i pazëvendësueshëm.

Të pranishëm ishin dhe politikanët, kyeministri Edi Rama, homologu i tij grek Kyriakos Mitsotakis, kreu i PD-së Sali Berisha, Presidenti Barjam Begaj, kryetarja e Kuvendit Elisa Spiropali, ministra dhe deputetë.

Mitropoliti i Korçës, imzot Joani, Kryeministri Edi Rama, kryeministri grek Kyriakos Mitsotakis, mbesa e kryepiskopit Anastas, Roksana Janullatos, kryetari i Komisionit Qendror të Këshillit Botëror të Kishave, Hirësia e tij Episkopi, Prof. Dr. Heinrich Bedform-Strohm dhe Patriarku Ekumenik Bartolomeu mbajtën fjalimin e tyre gjatë

ceremonisë ku përmendën veprat dhe kontributin e tij të çmuar në ngritjen e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë si dhe ndihmën dhe sakrificën e madhe për Shqipërinë dhe shoqërinë.

cna.al